



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 1434 prot.

Shkodër, më 27.04.2023

V E N D I M

Nr. 129, datë 27.04.2023

"Për miratimin e programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për vitin akademik 2023-2024"

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 18, pika 5, 35, 38, germa *dh*, Neni 74 dhe 75; Statutin e USH-së, Neni 11 pika 8 dhe Neni 17 pika 6, germa *f*; Udhëzimin Nr.3, datë 15.02.2023 "Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlerëshme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike", Senati Akademik, pasi mori në shqyrtim propozimin e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, në mbledhjen e tij të datës 27.04.2023

Vendosi:

1. Të miratojë programin e ri të Studimit të formimit të vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike.
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARË
Prof. dr. Suzana GOLEMI
SHKODËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Drejtoria e kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë

Nr. 1345 prot.

Shkodër, më 20.04.2023

Lënda: Kërkesë për miratimin e programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko- Pedagogjike për vitin akademik 2023- 2024.

Drejtuar Senatit Akademik

Drejtoria e kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë, pasi shqyrtoi dosjen për *Programin e Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko - Pedagogjike 35 ECTS* , për periudhën e studimit 2023-2024, të depozituar nga departamenti i Mësuesisë, i Fakultetit të Shkencave të Edukimit, ia paraqet për miratim Senatit Akademik.

DREJTORI

Prof.as.dr. Angjelina SHLLAKU

Nr. 1273 Prot

dt. 13. 04. 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Fakulteti i Shkencave të Edukimit

Dekani

Nr. 289 prot.

Shkodër, më 13. 04. 2023

Lënda: Dërgim i dosjes së Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko – Pedagogji, (35 ECTS), për miratim në Senatin Akademik dhe në Bordin e Administrimit.

DREJTORISË SË KURRIKULAVE, KËRKIMIT SHKENCOR DHE STANDARDEVE.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë Programin e Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogji, (35 ECTS), për miratim në Senatin Akademik dhe në Bordin e Administrimit.





UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT
DEPARTAMENTI I MËSUESISË

Lënda: Vendim për hapjen e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike.

Shkodër, më 13. 04. 2023

Vendim

Nr. 4, datë 13. 04. 2023

**Për hapjen e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar
në Fushën Psiko-Pedagogjike.**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë", Neni 81 (Programet e studimit të formimit të vazhduar), pikat 1, 2, 3 që lejon institucionet e arsimit të lartë për të zhvilluar programe të formimit të vazhduar, Vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; Vendimit Nr. 879, datë 18.12.2019, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; Vendimit Nr. 185, datë 25.03.2021, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar si dhe Udhëzimin Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS "Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/Lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike", mbështetur në Statutin e USH dhe Rregulloren e USH, Departamenti i Mësuesisë në mbledhjen e datës 13. 04. 2023, pas diskutimeve nga anëtarët e Departamentit me unanimitet mori vendimin, Për hapjen e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike, sistemi me kohë të plotë, me 35 kredite (ECTS), me kohëzgjatje 4.5 muaj (një semestër) si dhe miratoi planin mësimor të këtij programi studimi, me lëndët dhe ECTS përkatëse. Në përfundim të studimeve studenti do të pajiset me: "Certifikatë - Formim i Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike", lëshuar nga Universiteti Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Drejtori i Departamentit

Dr. Eranda Bilali Halluni

Eranda Halluni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Departamenti i Mësuesisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
PROJEKT-PROPOZIM PËR HAPJE PROGRAMI STUDIMI

1. Institucioni/IAL

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

2. Aplikimi:

Program i ri studimi

3. Emërtimi i programit të propozuar për hapje/riorganizim

Program Studimi për Formimin e Vazhduar
në Fushën Psiko-Pedagogjike.

4. Semestri dhe viti akademik i hapjes

Viti Akademik: 2023 – 2024 (semestri i parë – tetor 2023)

5. Semestri dhe viti akademik i diplomimit të parë

Semestri i dytë/Viti akademik 2023 – 2024

6. Të dhënat për aktin e hapjes/akreditimit të IAL dhe/ose njësisë kryesore që ofron programin e studimit.

Të dhënat për aktet themelore	Lloji i aktit (VKM/Urdhër)	Nr.	Datë
Licensimi i Institucionit	VKM VKM (emërtim i ri)	150 167	18. 04. 1957 28. 05. 1991
Leja për fillimin e veprimtarisë			01.06. 1957
Akreditimi i institucionit	Vendim	70	Vendimi nr. 03, datë 24.01.2020
Hapja/riorganizimi i njësisë kryesore ku ofrohet programi	VKM	167	28. 05. 1991

7. Vendimi i miratimit nga Senati Akademik /
Vendimi i miratimit nga Bordi i Administrimit

Vendim miratimi i Senatit Akademik për hapjen e programit të studimit –
Vendim miratimi nga Bordi i Administrimit –

8. Nëse është një program i përbashkët studimi identifikoj IAL-të bashkëpunuese dhe cito aktin e bashkëpunimit mes IAL-ve dhe marrëveshjen specifike për realizimin e programit të studimit.

Programi ofrohet nga USH, por ka struktura bashkëpunuese brenda e jashtë institucionit.

Struktura akademike përgjegjese dhe strukturat e tjera bashkëpunuese.

Fakulteti apo njësi akademike që e ofron	<i>USH - Fakulteti i Shkencave të Edukimit Departamenti i Mësuesisë</i>
Struktura të tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë.	Departamenti i Psikologjisë dhe punës sociale.
Subjekte të tjera publike apo private	DAR, Bashkia, Shkodër.

9. Programi ofrohet nga/në:

Departamenti i Mësuesisë
Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Kampusi/godina e FSHE.

10. Të dhëna mbi personat e kontaktit përgjegjës për programin e studimit:

Personeli akademik	Grada shkencore apo titulli akademik	Struktura së cilës i përket	Pozicioni	Tel	email
Eranda Bilali	Dr.	Departamenti i Mësuesisë	Përgjegjës Departamenti	0693117139	eranda.bilali@unishk.edu.al

II. AUTODEKLARIM

Në/Unë i/ e nenshkruari/a Prof Dr. Suzana Golemi

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

1. Të gjitha të dhënat janë të vërteta dhe jam i vetëdijshëm për përgjegjësinë penale në rast dhënie informacioni të pavërtetë, si dhe pranoj, t'i nënshtrohem verifikimit nga organet përkatëse për të gjithë informacionin e paraqitur si më sipër.
2. IAL - ja është e rregjistruar në QKB si person juridik, me të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në fushën përkatëse të arsimit, si më poshtë:
Subjekti juridik përgjegjës për IAL - në: Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Shkencave të Edukimit. NUIS:K56704006B.
3. Subjekti juridik nuk disponon vërtetim pronësie nga zyra e rregjistrimit të pasurive të paluajtshme, por disponon akt përdorimi me VKM.
4. Qeraje me kohëzgjatje jo më pak se tre vite akademike nga momenti i paraqitjes së kësaj kërkesë.
5. Deklaroj se subjekti juridik disponon mjedis të përshatshëm për realizimin e procesit mësimor bazën materiale të nevojshme sipas standartave shtetërore në fuqi.
6. Deklaroj se subjekti juridik ka krijuar kushte për studentët me aftësi të kufizuara në mjediset ku ushtrohet veprimtaria e mësimdhënies.
7. Subjekti juridik dhe personat përgjegjës për administrimin e tij nuk janë në proces gjykimi; hetimi si dhe nuk rezultojnë të dënuar në fushën që kërkohet të ushtrohet aktiviteti.
8. Deklaroj se subjekti plotëson të gjitha standartet akademike dhe shtetërore sipas kuadrit ligjor në fuqi.
9. Deklaroj se subjekti juridik plotëson të gjitha standartet infrastrukturore shtetërore sipas kuadrit ligjor në fuqi.
10. Deklaroj se subjekti juridik nuk rezulton debitor ndaj organeve tatimore në nivel qendror dhe vendor për të gjitha llojet e detyrimeve përfshirë energjinë elektrike dhe furnizimin me ujë.
11. Deklaroj se subjekti juridik disponon lejen Higjieno - Sanitare për çdo mjedis ku do të zhvillohet veprimtaria dhe aktin për mbrojtjen kundër zjarrit, brenda afateve të vlefshmerisë.
12. Deklaroj se aktiviteti juridik disponon vlerat monetare për financimin e programit përkatës të studimit dhe është përgjegjës ndaj studenteve për mosrespektimin e kontratave të lidhura.

Rektori i Universitetit të Shkodrës:

Prof. Dr. Suzana Golemi





PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PROPOZUAR PËR HAPJE

a) Të dhëna mbi programin e studimit:

1. Të dhëna të përgjithshme:

Emertimi i programit të studimit	Për Formimin Psiko-pedagogjik
Lloji i Programit	Formim i vazhduar
Totali i krediteve (ECTS)	35
Kohëzgjatja normale në vite	1 semestër
Forma e studimit	me kohë të plotë
Gjuha e studimit	Shqip
Njësia bazë / njësia kryesore ofruese e programit të studimit.	Departamenti i Mësuesisë/ Fakulteti i Shkencave të Edukimit

PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT, MISIONIT, QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E TIJ.

Programi për Formimin Psikopedagogjik është konceptuar si një qasje e re me qëllime, strukturë dhe përmbajtje. Ky program studimi përmban 35 kredite, është parashikuar të zhvillohet me kohëzgjatje 1 semestër, në formën me kohë të plotë. Programi përmbyllet me provim përfundimtar dhe pajis studentin me Certifikatë për Formimin Psikopedagogjik në zbatim të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS "Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/Lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike".

Certifikata e programit të studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psikopedagogjike do të mundësojë ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit edhe nga individë të cilët zotërojnë diploma universitare të njëvlershme, të ngjashme apo të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar për të plotësuar një sërë nevojash të tregut të punës në Rajon.

Profili i kualifikimit dhe statusi profesional është program studimi për Formimin e Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike.

Misioni dhe vizioni

Programi i studimit ka të përcaktuar në rregulloren e tij misionin dhe objektivat e tij. Programi i studimit ofron dije të përgjithshme dhe të veçanta të cilat përputhen me objektivat dhe misionin e tij dhe janë hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.

Programi i studimit për Formimin e Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e të gjithë mësuesve dhe individëve të cilët zotërojnë diploma universitare të njëvlershme, të ngjashme apo të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar. Këto objektiva përfshijnë dije, aftësi dhe kompetenca profesionale që duhet të fitojnë në përfundim të këtij programi studimi.



Misioni

Ë sigurojë një formim psikopedagogjik të mjaftueshëm në fushën e mësuesisë për ata që zotërojnë diploma universitare të njëvlershme, të ngjashme apo të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar.

Arsyetimi për nevojën e hapjes së programit.

Programi i studimit për Formimin e Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike do të mundësojë ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit edhe nga individë të cilët zotërojnë diploma universitare të njëvlershme, të ngjashme apo të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar.

Ky program mbështetet:

Së pari, në LAL 80/ 2015, datë 17. 09. 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, pika 1, 2 dhe 3 e Nenit 81 të këtij ligji që lejon institucionet e arsimit të lartë që të organizojnë programe të formimit të vazhduar. Së dyti, në dokumentacionin zyrtar i dakortësuar dhe I dorëzuar në MAS dhe ASCAP, produkt i takimit kombëtar të datës 11.11.2022 nga të gjithë përfaqësuesit e IAL publike I cili arriti dakordësinë duke hartuar kurrikulën e programit të formimit të vazhduar “Çertifikatë Për Formimin Psikopedagogjik” për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit nga individë të cilët zotërojnë diploma universitare të njëvlershme, të ngjashme apo ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar

Motivimi

Programi i studimit për Formimin e Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike do të mundësojë ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit edhe nga individë të cilët zotërojnë diploma universitare të njëvlershme, të ngjashme apo të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar. Hapja pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit në Universitetin e Shkodrës do të sillte risi për zhvillimin e mësuesisë duke vazhduar traditën e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në fushën e përgatitjes së mësuesive.

Udhëzimi Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS “Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/Lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike”, shprehet në pikën 1 që profesioni mësuesit mund të ushtrohet edhe nga individë që zotërojnë diploma universitare që kanë zgjatur së paku me 4 vite akademike deri në përshtatjen e studimeve sipas parimeve të Procesit të Bolonjës, diplomë universitare të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë ose diplomë universitare të integruar të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar. Gjithashtu detyron edhe plotësimin e germës b, që individët që plotësojnë pikën 1 duhet të zotërojnë një çertifikatë për formimin në fushën psikopedagogjike, të lëshuar nga insitucionet e arsimit të lartë që ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar në fushën e mësuesisë.

Në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit tashmë është formuar një eksperiencë e madhe në programet që përgatisin mësues për të gjitha ciklet e studimit çfare do të përbënte një bazë të fortë për Programin e studimit për Formimin e Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike.



Objektivat e programit:

Objektivat e programit të studimit për Formimin e Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike janë të përcaktuara qartë dhe përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë ata që zotërojnë diploma universitare të njëvlershme, të ngjashme apo të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar.

Plani mësimor, i hartuar dhe i titulluar me emrin “Certifikatë Për Formimin Psikopedagogjik” përmbush parametrat që kërkon Udhëzimit Nr 3, datë 15.02.2023 i MAS “Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/Lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike”, se:

- “Certifikata Për Formimin Psikopedagogjik” ka bashkë me provën finale 35 kredite, pra ka jo më pak se 30 kredite
- “Certifikata Për Formimin Psikopedagogjik” realizohet për një semestër, konform kërkesës së Udhëzimit Nr 3.
- Kurikula e “Certifikatës për Formimin Psikopedagogjik” është e unifikuar në masën mbi 80 % mes IAL-ve publike, IAL-ve Jo Publike dhe IAL-ve me status të veçantë, duke ju përgjigjur nenit 83 pika 4 të LAL 80/2015
- Kurikula e “Certifikatës Për Formimin Psikopedagogjik” lejon ndryshueshmëri mes IAL-ve - aplikuese deri në masës së lejuar 20 % . Kurikula e hartuar dhe e dakordësuar nga të gjitha IAL publike, IAL Jo -Publike dhe IAL me status të vecantë, ka module/lëndë të unifikuara të formimit të fushës psiko-pedagogjike dhe 1 modul/lëndë të ndryshme për secilën IAL sipas specifikave të tyre përkatëse

Profili profesional

Programi i studimit për Formimin e Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike e finalizuar me “Certifikatë për Formimin Psikopedagogjik ka si objektivi të sigurojë një formim profesional të mjaftueshëm në fushën e mësuesisë nga ata që zotërojnë diploma universitare të njëvlershme, të ngjashme apo të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar.

- a) Të dhëna mbi kriteret e pranimit në këtë program studimi, tarifa dhe modalitetet financiare për studentët:

Studentët që do rregjistrohen në Programin e studimit për Formimin e Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike duhet të kenë diplomë të ciklit të parë (Bachelor) dhe të ciklit të dytë (Master Profesional ose Master i Shkencave) jo në fushën e Mësuesisë.

Kriteret e pranimit:

Numri i propozuar i studentëve që do të pranohen në program	60
Numri minimal i studentëve për hapjen e programit	10
Bachelor dhe Master Profesional ose Master i Shkencave, jo në fushën e Mësuesisë	Të gjitha specialitetet

Tarifa e shkollimit

Tarifa e shkollimit për Certifikatë Për Formimin Psikopedagogjik		Kostoja e shkollimit	
---	--	----------------------	--

Burimi i financimit të programit janë të ardhurat nga studentët dhe nga burime të Universitetit. Finacime te tjera qe mund te mbulojne pjeserisht apo plotesisht koston e shkollimit, momentalisht nuk ka te tilla.

Konkurrimi për regjistrim në këtë program zhvillohet me dosje. Dokumentacioni për aplikim gjendet në shtojcën 1 të rregullores së programit (*bashkangjitur*).

Shtojca 1

Përmbajtja e dosjes së kandidatit për regjistrim në programin e studimit për Formimin e Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike.

Konkurimi për regjistrim në programin e studimit bëhet me dosje.

Dosja e çdo kandidati përmban dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim për tu regjistruar në programin e studimit për Formimin e Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike.
2. Kartë identiteti (fotokopje).
3. 2 (dy) foto.
4. Diplomë Bachelor/listën e notave, (fotokopje e noterizuar)
5. Master Profesional ose Master i Shkencave, jo në fushën e Mësuesisë, listën e notave, (fotokopje e noterizuar).
6. Plotësim i formularit (shtojca 6 MAS).
7. Mandat pagesa.

c) Plani mësimor/Kurikula e programit të studimit

Programi i studimit për Formimin e Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike është një program studimi me kohë të plotë dhe zgjat 1 semestër. Sasia e krediteve do të jetë 35 ECTS. E gjithë struktura e krediteve për secilën disiplinë është në përputhje të plotë me raportin që duhet të ekzistojë mes numrit të orëve në auditor dhe numrin e orëve për studim individual. Njëkohësisht orët në auditor për të gjitha disiplinat janë në përputhje me ngarkesën javore për orët në auditor që duhet të ndjekë një student gjatë një semestri., (shih plani mësimor Certifikatë për Formimin e Vazhduar në Fushën Psiko-pedagogjike).

Emertimi i diplomës : Certifikatë për Formimin Psikopedagogjik”

Kuadri i pergjithshem formues i programit te studimit është hartuar duke u bazuar në Udhëzimin Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS “Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/Lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike”. Ky udhëzim shprehet në pikën 1 që profesioni mësuesit mund të ushtrohet edhe nga individë që zotërojnë diploma universitare që kanë zgjatur së paku me 4



Vite akademikë deri në përshtatjen e studimeve sipas parimeve të Procesit të Bolonjës, diplomë universitare të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë ose diplomë universitare të integruar të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar. Gjithashtu detyron edhe plotësimin e germës b, që individët që plotësojnë pikën 1 duhet të zotërojnë një certifikatë për formimin në fushën psikopedagogjike, të lëshuar nga insitucionet e arsimit të lartë që ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar në fushën e mësuesisë.

Veprimtaritë mësimore të Programit të studimit për Formimin e Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike do të zhvillohet çdo ditë nga e Hëna deri të Premten pranë Fakultetit të Shkencave Edukimit, Departamenti i Mësuesisë të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Një orë në auditor do të jete 50 minutëshe.

Lëndët shoqërohen me seminare.

Frekuentimi i veprimtarive mësimore do të jetë si më poshtë:

Frekuentimi i leksioneve dhe seminareve është i detyrueshëm në masën 75%

Shih Plani Mësimor "Certifikatë për Formimin Psikopedagogjik"

d) Personeli akademik dhe ndihmës akademik

Departamenti i Mësuesisë ka në përbërje të tij një staf akademik të brendshëm prej 8 anëtarësh. Më poshtë lista e personelit të angazhuar: *(bashkangjitur dhe një CV e shkurtër e secilit)*

Personeli akademik per realizimin e programit

Personeli akademik (emri, mbiemri)	Titulli/ grada shkencore	Institucioni	Njësia kryesore	Njësia bazë	Lloji i angazhimit (me kohë të plotë/të pjesshme)
Fatmir Vadohej	Prof. dr.	Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Departamenti i Mësuesisë	Me kohë të plotë
Eranda Halluni Bilali	Dr	Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"	Fakulteti i Gjuhëve të huaja	Departamenti i Mësuesisë	Me kohë të plotë
Pranvera Kraja	Dr.	Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Departamenti i Mësuesisë	Me kohë të plotë
Rina Muka	Dr.	Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Departamenti i Mësuesisë	Me kohë të plotë
Arlinda Ymeri	Dr.	Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Departamenti i Mësuesisë	Me kohë të plotë
Megi Shllaku	Dr.	Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Departamenti i Mësuesisë	Me kohë të plotë
Roland Guli	Doc.	Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Departamenti i Mësuesisë	Me kohë të plotë




Biografi e shkurtër - CV (Curriculum Vitae)	
Informatat personale:	
Emri, Mbiemri:	Fatmir VADOHEJ
Datëlindja:	15.06.1958
Adresa:	Lagja "Voja Kushi, Rruga "7 Shkurti", Shkodër.
Gjinia	Mashkull
Te dhënat kontaktuese:	
Emal:	fatmir.vadahi@unishk.edu.al
Mob:	00355692283634
Te dhënat e kualifikimit:	<p>Diplomuar në I.L.P Shkodër (sot Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi") në vitin 1980 në degën Matematikë dhe Fizikë (numër diplome 1518).</p> <p>Diplomuar në Kursin Pasuniversitar në Universitetin e Tiranës për Psikologji dhe Pedagogji në vitin 1988-1989.</p> <p>Grada shkencore "Doktor i Shkencave Pedagogjike", (Nr. i diplomës 149, nr. i regjistrimit themeltar 3663, datë 08.06.1996).</p> <p>Titulli Prof. as. dr. në vitin 2001.</p> <p>Titulli Profesor në vitin 2020, (vendim nr 002, datë 24.02.2020).</p> <p>Kualifikuar për dy muaj në metodologjinë e mësimdhënies në Institutin Universitar të Formimit të Mësuesve Grenoblë, Francë në vitin 1994.</p> <p>Projekti për Ristrukturimin e Sistemit Arsimor në Shqipëri (Sistemi i Mentorëve), TEMPUS, MASH, ËEU, Bristol 1997 dhe 1999</p> <p>Kualifikuar për dy muaj në aspektin se si përgatitet nga ana psiko-pedagogjike studenti mësues i ardhshëm dhe si organizohen praktikat pedagogjike, në Universitetin Paris 13 dhe në Institutin Universitar të Formimit të Mësuesve, Montpelje në vitin 1998.</p>
Përvoja e punës/ Punësimi	<p>1980-1988 mësues dhe drejtues shkolle.</p> <p>1988-1989 kursi pasuniversitar për Psikologji dhe Pedagogji në Universitetin e Tiranës.</p> <p>1989, shtator e sot pedagog në Universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër, në Departamentin e Psikologjisë dhe të Pedagogjisë, sot Departamenti i Mësuesisë.</p> <p>2001 – 2003 - Specialist pranë Degës Mësimore e Shkencore të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".</p> <p>2004 – 2015 - Zv/Rektor i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".</p> <p>2015 – vazhdim – Dekan i Fakultetit të Shkencave të Edukimit i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".</p>

Biografi e shkurtër - CV (Curriculum Vitae)	
Informatat personale:	
Emri, Mbiemri:	Eranda HALLUNI BILALI
Datëlindja:	19.01.1971
Adresa:	L. "Kongresi i Përmetit", Rr. "Qazim Llazani", Shkodër, Albania
Gjinia	Femër
Te dhënat kontaktuese:	
Emali:	erandabilali@unishk.edu.al
Tel.&Mob:	Mobile:(0355) 693117139
Te dhënat e kualifikimit:	

Universiteti:	Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi "
Drejtimi/Diplomuar:	Mësuesi / Grada shkencore – Dr
	Fusha: Pedagogji / Metodologji e mësimdhënies
<i>Përvoja e punës/ Punësimi</i>	Përgjegjëse në Departamentin e Mësuesisë, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Biografi e shkurtër - CV (Curriculum Vitae)	
<i>Informatat personale:</i>	
Emri, Mbiemri:	Rina MUKA (GERA)
Datëlindja:	29. 06. 1979
Adresa:	L. "QemalStafa", Rr. "Lidhja e Prizrenit", 171, Shkodër, Albania
Gjinia	Femër
<i>Te dhënat kontaktuese:</i>	
Emali:	rina.geral1@gmail.com / rina.muka@unishk.edu.al
Tel.&Mob:	Mobile:(0355) 67 3233302
<i>Të dhënat e kualifikimit:</i>	
Universiteti:	Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi "
Drejtimi/Diplomuar:	Mësuesi / Grada shkencore – Dr
	Fusha: Pedagogji / Teknologji në Edukim
<i>Përvoja e punës/ Punësimi</i>	Pedagoge në Departamentin e Mësuesisë, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Biografi e shkurtër - CV (Curriculum Vitae)	
<i>Informatat personale:</i>	
Emri, Mbiemri:	Pranvera KRAJA(PUKA)
Datëlindja:	21. 03. 1973
Adresa:	L. "NaimGjylbegu", Rr. "Dr. Abdullah Mehmeti", Pall. 1101, Shkodër, Albania
Gjinia	Femër
<i>Te dhënat kontaktuese:</i>	
Emali:	v.kraja@yahoo.com / pranvera.kraja@unishk.edu.al
Tel.&Mob:	Mobile:(0355) 69 22 05 666
<i>Të dhënat e kualifikimit:</i>	
Universiteti:	Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi "
Drejtimi/Diplomuar:	Mësuesi/Grada shkencore – Dr
	Fusha: Pedagogji/Kërkim Shkencor në Edukim
<i>Përvoja e punës/ Punësimi</i>	Pedagoge në Departamentin e Mësuesisë, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Biografi e shkurtër - CV (Curriculum Vitae)	
<i>Informatat personale:</i>	
Emri, Mbiemri:	Artinda YMERI (HALLUNOVI)
Datëlindja:	09.10.1985
Adresa:	Rr. "Palok Kurti", Nd.31,H.8, Ap.7 4001. Shkodër, Albania
Gjinia	Femër



Te dhënat kontaktuese:	
Emali:	arlinda.ymeri@unishk.edu.al
Tel.&Mob:	(+355) 67 4201204
Të dhënat e kualifikimit:	
Universiteti:	Universiteti i Tiranës
Drejtimi/Diplomuar:	Psikologji Shkollore & Organizacionale / Grada shkencore- Dr
	Fusha: Psikologji Organizacionale/Psikologji Shkollore
Përvoja e punës/ Punësimi	Pedagoge në Departamentin e Mësuesisë, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Biografi e shkurtër - CV (Curriculum Vitae)	
Informatat personale:	
Emri, Mbiemri:	Megi VJERDHA (SHLLAKU)
Datëlindja:	05.02.1990
Adresa:	Rruga Kocej, Shkodër Shqipëri
Gjinia	Femër
Te dhënat kontaktuese:	
Emali:	megi.shllaku@unishk.edu.al
Tel.&Mob:	Mobile:(0355) 67 4276000
Të dhënat e kualifikimit:	
Universiteti:	Universiteti Papnor Salezian, Vatikan Grada shkencore- PhD
Drejtimi/Diplomuar:	Psikologji Klinike dhe Komuniteti/Psiko-pedagogji speciale
	Fusha: Psikologji klinike dhe komuniteti/ Psiko-pedagogji speciale
Përvoja e punës/ Punësimi	Pedagog në Departamentin e Mësuesisë, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Biografi e shkurtër - CV (Curriculum Vitae)	
Informatat personale:	
Emri, Mbiemri:	Roland GULI
Datëlindja:	08.12.1960
Adresa:	Rr. Kardinal KOLIQI, Nr 56, Shkodër, Albania
Gjinia	Mashkull
Te dhënat kontaktuese:	
Emali:	roland.guli@unishk.edu.al
Tel.&Mob:	(+355) 692041756
Të dhënat e kualifikimit:	
Universiteti:	Shkolla Preng Jakova/ Universiteti i Arteve
Drejtimi/Diplomuar:	Instrumentist Grada shkencore – MND(Muzike Dhome), Titulli Docent
	Fusha: Muzikë
Përvoja e punës/ Punësimi	Pedagog në Departamentin e Mësuesisë, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

e) Infrastruktura akademike në funksion të programit

Baza materiale për zhvillimin e këtij programi profesional është e përshtatshme. Kemi ambiente e laboratore me bazë materiale e kompjuterike të nevojshme, dhe vitet e fundit, janë realizuar bashkëpunime dhe kualifikime të stafit akademik përkatës në fusha speciale, të cilat janë integruar në dokumentacionin mësimor të propozuar.

MJEDISI I ZHVILLIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE I STRUKTURËS MENAXHUESE	
Mjedisi i zhvillimit të aktivitetit mësimor	Godina ku zhvillon mësimet Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Struktura përgjegjëse për menaxhimin administrativ e financiar	Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Departamenti i Mësuesisë/USH "L.Gurakuqi"

Fasilitetet kanë një rol të rëndësishëm në prmbushjen e misionit dhe objektivave të institucionit të tilla si burimet materiale, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj studenteve. Në përgjithësi Departamenti i Mësuesisë, në misionin e tij për të prmbushur objektivat e programeve të studimit që ofron, përdor mjediset apo infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, pjesë e të cilit është, por dhe më gjerë, të Universitetit.

Ndërkohë që mjediset e brendshme dhe fasilitetet ndihmëse përfaqësohen nga:

- Njësitë didaktike (salla të mëdha leksionesh, salla për seminare)
- Ambiente zyrash për stafin akademik, punonjësit ndihmës dhe ata mbështetës të pajisura me të gjitha pajisjet e domosdoshme
- Laboratorët
- Biblioteka USH.

Sistemi i shërbimit të internetit

Fakulteti i Shkencave të Edukimit, pjesë e të cilit është departamenti i Mësuesisë, në total ka në dispozicion një sipërfaqe rreth 3819 m², (gjithsej 3 kate). Mjediset mësimore janë të madhësive të ndryshme në përshtatje me natyrën e procesit mësimor që zhvillohet në to. Kapaciteti i klasave është i madhësive të ndryshme.

Të gjitha këto janë të orientuara sipas nevojave të stafit dhe institucionit; të gjitha hapësirat janë mirë të ndriçuara, një pjesë të kondicionuara dhe ajrosura, si edhe të pajisura me sistemin e ngrohjes qëndrore, të mbrojtjes nga zjarri, duke ofruar në këtë mënyrë kushte maksimale për punë dhe respektim të të gjitha standarteve të vendosura nga MAS. Tre nga sallat janë të pajisura me video projektor dhe shërbejnë për mësimdhënie bazuar në metodat didaktike me prezantime poërpont, video, etj. Këto salla shërbejnë edhe për prezantimet e detyrave të kursit apo temave të diplomave me fokus studentin dhe me pajisje baze materiale elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve të të dy cikleve.

Kjo bazë materiale, (kompjuteri, videoprojektor) është e përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit.

Përveç sallave për leksione e seminare, Departamenti i Mësuesisë ka në dispozicion një laborator që i dedikohet aftësisimit teknologjik të studentëve.

Laboratorët që disponon Departamenti i Mësuesisë përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve; bazë kompjuterike në laboratorin e TIK-ut në shërbim të disiplinave që mbulon Departamenti i Mësuesisë.

Në bibliotekën e universitetit ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit.

Kapacitetet në mjedise të përshtatshme për të zhvilluar procesin mësimor dhe administrative



Tabela 1		
Mjediset për FSHE përfaqësues për programin e studimit	TOTALI	m ²
Salla për leksione	4	310.2
Salla për seminare	4	100.0
Salla internet	1	50.2
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	10.2
Korridore hülle		846.9
Nyje hidrosanitare për studentët	6	39.3
Qendra e Shërbimit Psikologjik dhe Social	1	24.8
Norma (mesatare) m ² për student	6.1	

Tabela 2		
Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja m ²
Zyra për Dekanin & Zv dekanin, sekretare e Dekanit	3	70.2
Zyra për sekretarinë mësimore	1	22.10
Zyra për departamentet qendrat kërkimore	1	43.7
Mjedis për stafin e shërbimit	1	10.2
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	2	13.1
Norma (mesatare) m ² për person	9.94	

f) Analizë e tregut të punës

Studimi i tregut të punës për të diplomuarit në programin e studimit për Formimin e Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjik, (35 ECTS) është bërë nga MAS. Ata janë iniciatorët e hapjes së këtij programi studimi dhe organizuesit e një takimi me të gjithë dekanët e Fakulteteve të Shkencave të Edukimit. Nga ky takim u kriju një grup i cili hartoj planin mësimor dhe rregulloren përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Departamenti i Mësuesisë

**“RREGULLORE E
PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT
TË VAZHDUAR NË FUSHËN
PSIKO-PEDAGOGJIKE PËR USHTRIMIN E
PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË
MËSUESIT”**

Shkodër, 2023



KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Baza ligjore e Rregullores së Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar të Mësuesit, është:

Ligji Nr. 80 datë 17.09.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 81 i këtij ligji në pikat 1, 2, 3 që lejon institucionet e arsimit të lartë për të zhvilluar programe të formimit të vazhduar.

Udhëzimin Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS "Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/Lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike"

Statuti i Universitetit të Shkodrës : "Luigj Gurakuqi"

Rregullorja e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Aktet e brendshme rregullatore USH.

Neni 2

Objekti i Rregullores

Kjo Rregullore vendos rregullat normative për organizimin dhe funksionimin e "Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar të Mësuesit" dhe të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në zhvillimin e këtij programi. Rregullorja përcakton misionin e studimit dhe të kualifikimit, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve; rregullat për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, për vlerësimin, për certifikimin dhe parashikon sanksionet në rastin e shkeljes së rregullave.

Neni 3

Përmbajtja Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike
Plani mësimor përmban 6 module/lëndë të formimit psiko-pedagogjik, nga të cilat 5 module/lëndë bazë, dhe 1 modul /lëndë opsionale me zgjedhje nga module sipas specifikave të seciles IAL si dhe provën finale.

Qëllimi i përgjithshëm i programit të formimit është që studentët të fitojnë një sfond të gjerë dhe të qëndrueshëm shkencor, si dhe kompetenca që lidhen me formimin psiko-pedagogjik në aspektin teorik dhe atë praktik, që u mundëson ushtrimin e profesionit të mësuesisë, sipas fushës përkatëse të studentit në formimin e mëparshëm universitar.



KREU II ORGANIZIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Neni 4

Organizimi administrativ

4.1. Përgjegjësinë për organizimin e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar të Mësuesit e ka Departamenti i Mësuesisë.

Neni 5

Koordinimi dhe këshillimi

5.1. Departamenti i Mësuesisë ka koordinatorin për programin, i cili mban lidhjet me Departamentin dhe Fakultetin. Koordinatori koordinon aktivitetet rreth organizimit, menaxhimit dhe zhvillimit të programit, si dhe këshillon studentët në lidhje me studimet.

5.2. Staf i akademik i programit i këshillon studentët në lidhje me lëndët përkatëse.

Neni 6

Programi i studimit vazhduar

Programi i Studimit të Formimit të Vazhduar ofron një formim të specializuar në fushën psiko-pedagogjike dhe drejton studentin drejt specializimit të profesionit të mësuesisë. Ai realizohet me:

- 35 kredite;
- ofrohet me kohë të plotë.

Neni 7

Afati dhe e drejta e studimeve

7.1. Kohëzgjatja normale e studimit për Programin Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike me 35 kredite është 4,5 muaj ose 1 (një) semestër akademik.

Neni 8

Politika e regjistrimit dhe frekuentimit

8.1. Në këtë Program regjistrohen ata kandidatë që kanë mbaruar studimet universitare konform ankesit 1 të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS "Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/Lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike"

8.2. Kanë diplomë të ciklit të dytë Master i Shkencave, Master i Arteve ose master profesional me 120 kredite apo ekuivalente me to, të lëshuara nga insitucione të arsimit të lartë, programi i studimit të së cilave përputhet me një nga fushat / Lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar të përcaktuar në aneksin 1 të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS

8.3. Kanë mesataren e maturës shtetëror që lejon studime bachelor në mësuesi, sipas ligjeve në fuqi.

8.4. Frekuentimi i studentëve është i detyrueshëm për të gjitha modulet/lëndët mësimore dhe provën finale.

8.5. Pjesëmarrja në orët mësimore në auditor është e detyrueshme për të marrë kreditet e përcaktuara për modulet/lëndët.

8.6. Mungesa në mësim në programet me kohë të plotë është e pranuar deri në masën 25% të orëve mësimore të parashikuara në auditor.

Neni 9

Procedura për frekuentimin

- 9.1. Pedagogët duhet të mbajnë shënime për frekuentimin e studentëve.
- 9.2. Pedagogët duhet të njoftojnë studentët për pasojat e mungesave në vlerësim.
- 9.3. Studenti që mungon duhet të njoftojë pedagogun e lëndës.
- 9.4. Pedagogu i lëndës plotëson skedën e krediteve të lëndës për secilin student të cilën student i paraqet në sekretarinë mësimore për t'u regjistruar në provim.

Neni 10

Struktura e studimeve

1. Cikli i studimit: Programi i Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike
2. Emërtimi i Certifikatës: **"Certifikatë e Programit Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike"**
3. Kohëzgjatja e Programit të Studimit të Vazhduar dhe Kualifikimit: 4,5 muaj (1 semester)
4. ECTS total: 35 ECTS
5. Forma e zhvillimit të programit: Me kohë të plotë

Neni 11

Plani mësimor

- 11.1. Plani mësimor përmba 5 lëndë mësimore bazë, 1 lëndë opsionale nga një numër lëndësh që vendosen sipas specifikave të secilës IAL dhe provën finale. Plani mësimor ndërtohet me lëndë të formimit të domosdoshëm psiko-pedagogjike, konform materialit të dakordësuar dhe miratuar nga Grupi i Punës i Urdhëruar nga MAS me Urdhër Nr.115, datë 27.02.2023.
- 11.2. Plani mësimor miratohet me vendim të Senatit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Neni 12

Programi i lëndës

- 12.1. Programi i lëndës hartohet dhe nënshkruhet nga titullari i saj, sipas formatit standard të miratuar nga USH dhe konform VKM Nr. 41, datë 22.2.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".
- 12.3. Programet e lëndëve depozitohen në Departament.

Neni 13

Format e mësimit

- 13.1. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, diskutimeve, debatit, punës në grupe, studimit të rastit, simulimeve, prezantimeve, praktikës.
- 13.2. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 50 minuta.
- 13.3. Veprimtaria mësimore e programit zhvillohet në gjuhën shqipe.

Neni 14

Praktika

Komponenti i praktikës zhvillohet pas përfundimit të këtij programi dhe menaxhohet nga institucionet e arsimit parauniversitar në varësi të Zyrave Arsimore Vendore, ku ka vendbanimin studentit, me një afat kohor konform ligjeve në fuqi, që adresojnë licensimin e profesionit të mësuesisë dhe është objekt monitorimi dhe vlerësimi nga ZVA-të.

KREU III

VLERËSIMI I STUDENTIT

Neni 15

Kritere dhe procedura të vlerësimit

15.1. Kriteret dhe format e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programin e lëndës dhe i bëhen të njohura studentëve në fillim të tyre.

15.2. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: a) me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; b) me detyra kursi, projekte, ese; c) i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi.

15.3. Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në përfundim të saj.

15.4. Notat vendosen në bazë të pikëve.

15.5. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash.

15.6. Vlerësimi kryhet sipas sistemit të detajuar më poshtë:

15hkalla e pikëve	Nota numerike	Përshkrimi i notës	Nota shkronja me shkronja
96 – 100	10	Shkëlqyeshëm	A+
86- 95	9	Shumë mirë	A
76-85	8	Mirë	B+
66-75	7	Kënaqshëm	B
56 – 65	6	Mjaftueshëm	C
50 – 55	5	Kalueshëm	D
≤49	4	Mbetës	FX
	3, 2, 1	Mbetës	F
		E papërfunduar*	
		Nuk ka të dhëna**	

*E papërfunduar

Një notë e papërfunduar mund t'i shënohet një studentit në qoftë se ai nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e lëndës deri në fund të semestrit, por ka kryer një sasi të konsiderueshme të punës. Është përgjegjësi e studentit të njoftojë pedagogun dhe të arrijë një marrëveshje për plotësimin e pjesës tjetër të modulit/lëndës. Në qoftë se kërkesat nuk plotësohen brenda një viti, atëherë automatikisht shënohet notë pakaluese.



*** Nuk ka të dhëna për notën

Ky shënim do të vendoset në pasqyrën e rezultateve të studentit në atë rast kur studentit është regjistruar për modulin/lëndën dhe nuk është shënuar asnjë notë nga pedagogu. Kjo nuk ka efekt në mesataren e studentit dhe mund të shndërrohet në notë numerike dhe me shkronjë, atëherë kur pedagogu vendos notën në procesverbal.

Neni 16

E drejta për të hyrë në provim

16.1. Studenti fiton të drejtën të futet në provimin e një lënde, kur ka shlyer detyrimet që lidhen me atë lëndë, të parashikuara për shlyerje në planin mësimor/programin lëndor dhe kur ka marrë skedën e krediteve për frekuentimin e lëndës, të firmosur nga pedagogu i lëndës.

16.2. Studenti nuk mund të hyjë në të njëjtën ditë në dy provime në lëndë të ndryshme.

16.3. Studenti mbetet ka të drejtë të riprovohet edhe dy herë të tjera.

Neni 17

Zhvillimi i provimeve

17.1. Provimet zhvillohen në përfundim të kursit, duke përcaktuar një sezon 2 javor për përfundimin e tyre

17.2. Provimet dhe riprovimet, detyrat e kursit dhe prezantimet zhvillohen sipas afateve të caktuara në strukturën e vitit akademik.

17.3. Në rast pamundësie të jashtëzakonshme të zhvillimit të provimit ose të prezantimit ditën e caktuar, përgjegjësi i departamentit me urdhër me shkrim, cakton një datë tjetër të mëvonshme e cila u bëhet e njohur studentëve dhe pedagogëve.

17.4. Provimet vlerësohen nga pedagogu/pedagogët që kanë zhvilluar lëndën. Në raste të veçanta departamenti cakton një komision tjetër.

Neni 18

Riprovimi

18.1. Riprovimi në një lëndë të caktuar kryhet dy javë pas provimit të dhënë më parë.

Neni 19

Komunikimi i vlerësimeve

19.1. Vlerësimet për provimet komunikohen nga Sekretaria mësimore.

Neni 20

Dokumentimi i vlerësimeve

20.1. Vlerësimet dokumentohen në Fletën e vlerësimit dhe në Regjistrin e rezultateve akademike.

20.2. Fleta e vlerësimit plotësohet nga pedagogu në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se 5 ditë nga dita e provimit ose e prezantimit të detyrës së kursit. Fleta e vlerësimit firmoset nga përgjegjësi i departamentit dhe kryesekretari.

20.3. Në asnjë rast Fleta e vlerësimit nuk duhet të ketë korrigjime dhe askush nuk ka të drejtë të shtojë emra në të.

KREU IV CERTIFIKIMI

Neni 21

Procedura e Certifikimit

21.1. Certifikimi i studentit bëhet pasi ai/ajo ka shlyer të gjitha provimet e lëndëve sipas planit mësimor, si dhe provën finale.

21.2. Certifikata nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit.

Neni 22

Marrja e certifikatës

22.1. Tërheqja e certifikatës bëhet personalisht nga student i certifikuar, kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin e diplomave/certifikatave.

KREU V PRANIMI I STUDENTËVE

Neni 23

Politika dhe kriteret e pranimit

23.1. Pranimi i kandidatëve bëhet me aplikim të studentëve. Kandidati aplikues duhet të zotërojë një diplomë të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor që të jetë në fushë lëndët e arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë konform ankesit 1., të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS "Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike"

23.2 Kandidati duhet të ketë edhe Diplomë të ciklit të dytë Master i Shkencave, Master i Arteve ose master profesional me 120 kredite, apo ekuivalente me to, të lëshuara nga insitucione të arsimit të lartë, programi i studimit të së cilave përputhet me një nga fushat/ lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar të përcaktuar në aneksin 1 të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS

23.2.Për aplikantët që kanë fituar diplomë/diploma studimi jashtë vendit duhet të kenë ekuivalentuar studimet e tyre në institucionet përgjegjëse në Shqipëri, por dhe që janë konform kërkesave të pikës 23.1.

Neni 24

Dokumentacioni i pranimit

1. Kërkesë me shkrim për tu rregjistrua në programin e studimit për Formimin e Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike.
2. Kartë identiteti (fotokopje).
3. 2 (dy) foto.
4. Diplomë Bachelor/listën e notave, (fotokopje e noterizuar)
5. Master Profesional ose Master i Shkencave, jo në fushën e Mësuesisë, listën e notave, (fotokopje e noterizuar).
6. Plotësim i formularit (shtojca 6 MAS).



Mandat pagesa.

Neni 25

Informacioni për kriteret dhe procedurat e pranimit

Informacioni për kriteret dhe procedurat e pranimit publikohet:

- në faqen e Internetit të USH
- në medien e shkruar dhe elektronike;
- në paketën e informacionit të studimeve vazhduar që ofron USH.

KREU VI STUDENTËT

Neni 26

Të drejtat e studentëve

Studentët kanë këto të drejta:

- a. Të udhëhiqen nga rregulla dhe procedura të formuluar qartë dhe të justifikuara në aspektin akademik.
- b. Të jenë të mbrojtur nga diskriminimi i çdo lloji ose nga ndonjë kriter i papërshtatshëm i vlerësimit akademik.
- c. Të kenë në dispozicion të gjithë informacionin që u takon të kenë për të gjitha çështjet akademike dhe veprimtarinë e shkollës.
- d. Të përdorin pajisjet e USH, sipas rregullave përkatëse për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tyre shkencor, bibliotekën dhe Internetin;
- e. Të paraqesin pikëpamjet e tyre pa frikë nga ndëshkimi.
- f. Të përfaqësohen në organet drejtuese të USH
- g. Të refuzojnë të kryejnë detyra që nuk lidhen me zhvillimin profesional.

Neni 27

Përgjegjësitë e studentëve

Studentët kanë këto përgjegjësi:

- a. Të njohin dhe të zbatojnë Rregulloren e "Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar të Mësuesit", kërkesat e programit të studimit dhe të jenë të vetëdijshëm për zbatimin e tyre, në të kundërt USH nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.
- b. Të sillen në një mënyrë profesionale dhe qytetare në tërë ndërveprimet në institucion me drejtuesit, personelin akademik dhe administrativ, studentët e tjerë dhe bashkëpunëtorët e departamentit.
- c. Të përmbushin në kohë të gjitha kërkesat dhe detyrimet e programeve lëndore dhe të praktikës.
- d. Të respektojnë kohën e pedagogëve.
- e. Të paguajnë tarifën e regjistrimit dhe tarifën e studimit në afatet e caktuara.
- f. Të mbajnë përgjegjësi për shkeljet e rregullave USH nga ana e tyre.

Neni 28
Përgjegjësitë e Departamentit i Mësuesisë.

- a) Departamenti i jep studentëve gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me Rregulloren, politikën e zhvillimit të programit, kriteret e pranimit, planin dhe programet lëndore, rregullat e vlerësimit, rregullat e certifikimit, rregullat financiare.
- b) Respekton të gjitha kriteret profesionale, shkencore dhe pedagogjike për mësimdhënien, praktikën, vlerësimin.
- c) Asiston studentët në plotësimin e kërkesave që lidhen me zbatimin e programit të studimit.
- d) Krijon kushtet e përshtatshme për realizimin e programit (siguron mjediset, rrjetin e informacionit, vë në dispozicion bibliotekën, mjete mësimore dhe teknologjinë elektronike).

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 29

29.1. Kjo rregullore mund të përmirësohet ose të korrigjohet gjatë punës pjesërisht ose tërësisht nga Departamenti i Mësuesisë.

29.2. Një kopje e kësaj rregulloreje depozitohet në protokollin e USH

29.3. Të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje e ka Zyra Juridike e USH.

Përgjegjës i Departamentit

Dr. Eranda Halluni Bilali

Eranda Halluni Bilali

Shkodër, Prill, 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Departamenti i Mësuesisë
PLAN MËSIMOR
**I PROGRAMIT TË STUDIMIT FORMIM I VAZHDUAR
NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE**

Nr	Emërtimi Lëndës	Kredite	Orë Gjithsej	Orë leksione	Orë seminare	Orë praktike	Orë jashtë Auditorit	Ngarjesa javore
1.	Zhvillimi Kurrikules Moduli. Kurrikula Moduli. Arsimi gjithëpërfshirës	5	125	30	30		65	2/2
2.	Metodologji e mësimit dhe të nxënit Moduli. Metodat e mësimit dhe të nxënit Moduli. Mendimi kritik Moduli. Të nxënit	7	175	60	30		85	4/2
3.	Vlerësimi i të nxënit	6	150	30	30		90	2/2
4.	Psikologji Zhvillimi dhe Edukimi Moduli. Psikologji Zhvillimi Moduli. Psikologji Edukimi	6	150	60	15		75	4/1
5.	Menaxhimi Klasës	3	75	15	15		45	1/1
6.	Lëndë me zgjedhje Teknologji në edukim Të mësuarit përmes artit Psiko-pedagogji komunikimi	3	75	15	15		45	1/1
7.	Prova Finale	5	125				125	
TOTALI		35	875	210	135		530	23

